REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
AGJENCIA E SHERBIMEVE UTILITARE KOMUNITARE DHE ADMINISTRATIVE

PROJEKT -VENDIM
Nr. 15 **Date** 20 / 02 /**2025**

"PËR MIRATIMIN E NDIHMES FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NGA FONDI REZERVE I BASHKISË PËR QYTETARË NË NEVOJË"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkonja b, nenit 54, Nenit 55, Ligjit Nr. 68 datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise" :

PROPOZOJ:

1. Miratimin e ndihmës financiare brenda fondeve rezervë të miratuara për vitin 2025, për përballimin e shpenzimeve të varrimit për familjët në nevojë bazuar në faturën e furnitorëve si më poshtë:
   - ✓ Znj. Marika Daut Nebo në vlerën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë sipas faturës.
2. Këto Shpenzime do të përballohen nga fondi rezervë i vitit 2025.
3. Për zbatimin e tij ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit.
4. Ky vendim do të hyjë ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 te Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Konceptoi:
Specialist i Agjencisë së Shërbimeve
Ervin Çokani
Konfirmoi Vlerën Financiare:
Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Buxhetit
Aurela Furxhi
Konfirmoi Bazën Ligjore:
Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Juridike
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
AGJENCIA E SHERBIMEVE UTILITARE KOMUNITARE DHE ADMINISTRATIVE

Nr. 739 Prot. Datë 6/02/2025

RLEACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E NDIHMES FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NGA FONDI REZERVE I BASHKISË PËR QYTETARË NË NEVOJË"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Devoll!

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkonja b, nenit 54, Nenit 55, Ligjit Nr. 68 datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise" po ju paraqesim relacionin mbi projekt-vendimin e shpenzimeve të varrimit si më poshtë:

Mbi rastin e të ndjerës: Znj.Marika Daut Nebo e datëlindjes 06.02.1942 me Nr ID E25206086S, lindur në Dobranj – Devoll dhe banuese në fshatin Bitinckë , Nj.A. Qendër Bilisht. E ndjera përfitonte një pension pleqërie në shumën prej 13,788 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë . Ajo ndodheshe në kushte të vështira ekonomike. Prej disa vitesh jetonte në qytetin e Bilishtit tek vajza e vogël pasi shtëpia ku e ndjera banonte në fshatin Bitinckë ishte në kushte të papërshtatshme për të jetuar (shtëpi e rrënuar). Vajza me të cilën e ndjera jetonte është kujdesur për nënën e saj për ti ofruar një strehë banimi dhe sigurimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme si sigurimin e ushqimit dhe ilaceve. Vetë vajza e të ndjerës përballet me vështirësi ekonomike pasi rezulton kryefamiljare e papunë dhe për këtë arsye e ka shumë të vështirë mbulimin e shpenzimeve të varrimit të nënës të saj.

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

E ndodhur në këto kushte familja e të ndjeres Znj.Marika Daut Nebo nuk ka mundësi financiare për përballimin e shpenzimeve të funeralit nga Agjensia Kosta Hoxha. Kërkojmë që të mbulohen shpenzimet nga institucioni i Bashkisë Devoll.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Specialist i Agjencisë së Shërbimeve
Ervin Çokani

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIADEVOLL

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT

SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Bilisht më,___/____/2025

Relacion

Mbi rastin e të ndjerës znj. Marika Nebo.

Znj. Marika Daut Nebo e datëlindjes 06.02.1942 me nr. ID E25206086S, lindur në fshatin Dobranj dhe me gjëndje civile rezulton banore e fshatit Bitinckë Nj.Ad.Q. Bilisht, ndodhet në kushte shumë të vështira ekonomike. I vetmi burim të ardhurash ishte pagesa e pensionit të pleqërisë me vlerë 13.788 (trembëdhjetë mijë e shtatëtqind e tetëdhjetë e tetë) lekë. Ajo prej disa vitesh jetonte në qytetin Bilisht tek vajza e vogël pasi shtëpia ku ajo banonte më parë në fshatin Bitinckë ishte në kushte të papërshtatshme banimi (e rrënuar). Vajza më të cilën jetonte e ndjera është kujdesur për nënën për t'i afrouar një strehë të ngrohtë banimi dhe sigurimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme për jetesën e Znj. Marika si sigurimi i ushqimit dhe ilaçeve.Vajza e të ndjerës përballet me vështirësi ekonomike edhe për nevojat e saj të përditshme pasi rezulton kryefamiljare e papunë dhe për këtë arsye e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve të varrimit të nënës së saj.

Konceptoi: Sp.e Adm te Nevojave per Strehim

L.Laçi

Pranoi:Përgjegjës i Sekt.te Kujd.Soc.dhe PAK.

M.Bejleri

Konfirmoi: Dr.i Sherb.Soc.Shendet.dhe Strehimit

Z.Sinani

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail:
*bashkiadevoll@gmail.com;info@bashkiadevoll.gov.al*Ëeb:*http://bashkiadevoll.gov.al/*